



## **KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e Teknologjisë së Informacionit, ushtruar në Universitetin e Sporteve të Tiranës**

### **RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**PËR AUDITIMIN E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT**

**NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS**



**Tiranë, Qershor 2025**

## PËRMBAJTJA

<b>Nr.</b>	<b>EMËRTIMI</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>3</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3.	Konkluzioni i përgjithshëm i Auditimit	4
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	5
2.	Identifikimi i çështjes	5
3.	Përgjegjësitë e subjektit të audituar	5
4.	Përgjegjësitë e audituesve	5
5.	Kriteret e vlerësimit	6
6.	Standardet e auditimit	6
7.	Metodat e auditimit	6
8.	Dokumentimi i auditimit	6
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	
1.	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	7
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Menaxhimi i Infrastrukturës së TI dhe Sigurisë së Informacionit	7-13
2.2	Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output	13-26
<b>IV.</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>27-31</b>

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

KLSH mbështetur në Ligjin nr.154, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin mbi Teknologjinë e Informacionit në Universitetin e Sporteve të Tiranës - UST, nga data 08.01.2025 deri në 21.02.2025.

Grupi i auditimit pasi mblodhi informacione të mjaftueshme, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në këto të dhëna hartoi drejtimet e auditimit. Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

### 1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Auditimi me objekt “Auditimi i sistemeve të teknologjisë së informacionit”, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, është pjesë e Planit Vjetor të auditimit për vitin 2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-s.

Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH ka vlerësuar të rëndësishëm auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, që ka në përdorim UST. Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr. 1460/1, me datë 31.12.2024 dhe përfundimi i tij në terren përfundoi në afatin e përcaktuar në program.

### 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

*Paraqitja e gjetjeve kryesore:*

- Nga auditimi mbi dokumentacionin e hartuar në drejtim të sigurisë së informacionit u konstatua se, nuk janë hartuar politika të sigurisë së informacionit, mungesa e të cilës krijon një mjedis të paorganizuar dhe të rrezikuar ndaj sulmeve dhe dëmeve të pakthyeshme për të dhënat që institucioni gjeneron, përpunon dhe ruan, në kundërshtim me Standardet Ndërkombëtare të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022.
- Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Sporteve të Tiranës nuk e ka të mundur të hartojë një plan vazhdimësie, për sa kohë shërbimet kryesore që janë konektiviteti në internet dhe portali i menaxhimit të studentëve, ofrohen nga Rrjeti Akademik Shqiptar. Në marrëveshjen 1 vjeçare hartuar ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Rrjetit Akademik Shqiptar me nr.863, prot. datë 21.03.2024, me objekt “*Për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit*”, u konstatua se nuk janë përcaktuar mundësitë e zgjidhjes teknike si dhe koha e nevojshme për rikthimin e shërbimit, në rast ndërprerje, bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare për menaxhimin e vazhdimësisë së shërbimeve IT.
- Nga auditimi u konstatua se nuk janë ngritur grupe pune me qëllim: hartimin e rregullores për sistemin Pitagora, hartimin e rregullores për sistemin e monitorimit me video mbikëqyrje në Universitetin e Sporteve të Tiranës, përditësimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me marrëveshjen kuadër nr. 863 prot; datë 21.03.2024 “*Për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit*”. Mungesa e grupeve të punës për hartimin e rregulloreve të nevojshme kufizon kapacitetin e institucionit për të menaxhuar në mënyrë të rregullt dhe të sigurt sistemet informatike, monitorimin me video dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke rritur riskun e rrjedhjes së informacionit.
- Nga auditimi u konstatua se në sistemin Pitagora mungon një funksionalitet i dedikuar për gjenerimin automatik të notave dhe krediteve, për vërtetimin dhe suplementin e diplomës, të cilat lëshohen nga sekretariati në përfundim të ciklit të studimeve. Mungesa e funksionalitetit shton mundësinë për gabime njerëzore gjatë përpunimit manual të të dhënave dhe nuk përputhet

me praktikat më të mira për menaxhimin e të dhënave.

*Paraqitja e rekomandimeve kryesore:*

- Universiteti Sporteve të Tiranës të marrë masa, për hartimin dhe miratimin e Politikave të Sigurisë së Informacionit, si dokumenti që përcakton rregullat, përgjegjësitë dhe masat për mbrojtjen e të dhënave dhe sistemeve.
- Universiteti i Sporteve të Tiranës, në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, të marrin masa për rishikimin e marrëveshjes ekzistuese dhe të përcaktojnë qartë mundësitë teknike, për backup dhe rikthimin e shërbimeve në rast të një ndërprerje të papritur ku të përfshihen:
  - Plani i rikuperimit dhe kohës së pritshme për rikuperimin e shërbimit;
  - Identifikimin e përgjegjësive të secilës palë në procesin e rikuperimit;
  - Vendosjen e mekanizmave për njoftimin dhe koordinimin në rast ndërprerje.
- Universiteti i Sporteve Tiranë të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me qëllim hartimin e rregullores për sistemin Pitagora, hartimin e rregullores për sistemin e monitorimit me video mbikëqyrje në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe përditësimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale.
- Universiteti i Sporteve Tiranë në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, të marrin masa për ndërtimin dhe integrimin e një funksionaliteti në sistemin Pitagora, që mundëson gjenerimin automatik të notave dhe krediteve të studentëve. Kjo do të ndihmojë në reduktimin e punës manuale nga sekretariati dhe në shmangien e gabimeve njerëzore.

### **3. Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit**

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, dhe në analizën e evidencave dhe gjetjeve të auditimit të kryer, konstatohet se Universiteti i Sporteve të Tiranës nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për të siguruar një sistem të qëndrueshëm për menaxhimin e sigurisë së informacionit.

Auditimi evidentoi mungesën e politikave të sigurisë së informacionit në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe aktet ligjore në fuqi, si dhe mungesën e mekanizmave të kontrollit për menaxhimin e aksesit të përdoruesve në infrastrukturën e teknologjisë së informacionit.

Gjithashtu, u evidentua përdorimi i pajisjeve me sisteme operative të pa përditësuara, mungesa e masave të nevojshme të sigurisë teknike, si programe antivirus, si dhe përdorimi i pakontrolluar i pajisjeve të jashtme (USB), të cilat ekspozojnë institucionin ndaj rreziqeve të sigurisë.

Një tjetër mangësi përbën mungesa e një plani të formalizuar për vazhdimësinë e shërbimeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, përfshirë masat për mbrojtjen nga humbja apo komprometimi i të dhënave administrative dhe akademike.

Institucioni nuk ka përcaktuar strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe zbatimin e marrëveshjes kuadër me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH), çfarë përbën një risk në zbatimin e detyrimeve kontraktuale.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit nr. 1460/1 prot., datë 31.12.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 08.01.2025 deri më datë 21.02.2025, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, u krye auditimi mbi teknologjinë e informacionit, nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E. C, përgjegjëse grupi;
2. A. M, anëtare.

### 1. Objektivat dhe qëllimi

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, zhvilloi auditimin e teknologjisë së informacionit në UST, nga data 08.01.2025 deri më datë 21.02.2025. Kërkesat për informacion sipas drejtimeve të programit të auditimit, u hartuan në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

*Objekti i Auditimit TIK* është përcaktimi nëse objektivat e UST arrihen në mënyrën e duhur duke përdorur burimet IT, përfshirë pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullative, konfidencialitetin, integritetin si dhe disponueshmërinë e informacionit që gjenden në të.

*Qëllimi i Auditimit TIK* është vlerësimi nëse ekzistojnë kontrollet dhe mekanizmat e duhur me qëllim krijimin, mirëmbajtjen, zhvillimin e burimeve IT dhe funksioneve të UST.

### 2. Identifikimi i çështjes

Drejtimet e këtij auditimi janë bazuar në programin me nr. 1460/1, me datë 31.12.2024:

1. Menaxhimi i Infrastrukturës së TI dhe Sigurisë së Informacionit
2. Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output.

### 3. Përgjegjësitë e subjektit të audituar

UST është krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.123, datë 17.02.2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”. Ky universitet është i vetmi institucion i lartë i këtij lloji në Republikën e Shqipërisë dhe ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit të lartë në fushën e sportit, edukimit fizik dhe shëndetit. Përgjegjësitë e tij janë të përqendruara në sigurimin e një formimi universitar cilësor, integrimin e mësimdhënies me kërkimin shkencor dhe përgatitjen e specialistëve të sportit, ku realizohet kualifikimi i plotë shkencor i specialistëve të edukimit fizik dhe të sporteve, deri në nivelin “Master” dhe “Doktor i Shkencave”.

### 4. Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi UST mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 deri në 31.12.2024, në drejtim të teknologjisë së informacionit, që është në përdorim dhe i shërben institucionit.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban programi i auditimit nr. 1460/1 Prot., datë 31.12.2024 miratuar nga Kryetari i KLSH-s. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit të teknologjisë së informacionit si dhe legjisllacionin e fushës në të cilën operon UST. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese është siguruar një evidencë e përshtatshme e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve.

## 5. Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare dhe ISSAI 5300 - Udhëzime për Auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikat më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar marrjen e masave, për përmirësimin e situatës.

*Kriteret ligjore, rregullative mbi të cilat është mbështetur auditimi, janë si më poshtë:*

- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Statuti i Universitetit të Sporteve, i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Marrëveshja ndërmjet UST dhe RASH për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit për vitin 2023 dhe vitin 2024.
- Vendimi nr.28, datë 19.05.2017 “Për miratimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin dhe sigurinë e të dhënave personale”.
- Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së UST-ës.

## 6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik, Standardet dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë dhe të qartë. Standardet e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit që kanë shërbyer si kriter vlerësimi janë: ISSAI 5300, ISSAI 5310, ISO/IEC 27001:2022 dhe ISO/IEC 27002:2022.

## 7. Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur, janë si më poshtë:

- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullatorë të institucionit dhe sistemit informatik;
- Pyetësorë drejtuar institucionit;
- Intervista zhvilluar me personat përgjegjës;
- Vëzhgim i funksioneve të sistemit, analizim i të dhënave të eksportuara prej tij.
- Testime funksionale të sistemit.

## 8. Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH, si dhe në manualin e auditimit të Teknologjisë së Informacionit, në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, të dhëna dhe informacione të ndryshme të gjeneruara nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

### III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

#### 1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Universiteti i sporteve të Tiranës krijuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.123, datë 17.02.2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”, është i vetmi institucion i lartë i këtij lloji në Republikën e Shqipërisë dhe ka një rol të rëndësishëm në zhvillimin e arsimit të lartë në fushën e sportit, edukimit fizik dhe shëndetit.

Auditimi kishte si synim vlerësimin e ligjshmërisë në lidhje me menaxhimi i infrastrukturës së teknologjisë së informacionit dhe sigurisë së tij si dhe të dhënat Input/Output në sisteme informatike, që disponon / përdor për veprimet administrative dhe akademike.

Aktiviteti operacional i universitetit bazohet në pjesën më të madhe të tij në sistemin informatik “Pitagora”, një sistem menaxhimi akademik për arsimin e lartë, vënë në dispozicion nga Rrjeti Akademik Shqiptar.

Gjithashtu, Rrjeti Akademik Shqiptar ofron për UST dhe shërbimin e internetit, si pjesë e marrëveshjes kuadër ndërmjet dy institucioneve.

Ndërprerja apo mosfunksionimi për këto shërbime, mund të pengojë në disa aspekte funksionimin e UST-ës, disa prej të cilave janë:

- pamundësi për të aksesuar të dhënat e studentëve dhe stafit akademik;
- pamundësia për të hedhur të dhënat mbi rezultatet e provimeve dhe notat;
- vështirësi në menaxhimin e testimeve, provimeve dhe vlerësimeve;
- vonesat në proceset akademike;
- impakt në komunikimin institucional si dhe në reputacionin e universitetit.

#### 2 Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit

##### 2.1 Menaxhimi i Infrastrukturës së TI dhe Sigurisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 1 “Menaxhimi i Infrastrukturës së TI dhe Sigurisë së Informacionit”, u shqyrtua, si më poshtë:

- Struktura organizative dhe rolet përgjegjëse për menaxhimin e IT-së;
- Kontrata e shërbimit me RASH;
- Skema të networkut që disponon UST;
- Workflow dhe dizajni i rrjetit, menaxhimi i rrjetit dhe pajisjeve IT;
- Sistemet operative dhe versionet e tyre (patching & updates);
- Ruajtja dhe rikuperimi i të dhënave;
- Politikat për mbrojtjen e të dhënave personale;
- Mbrojtja nga Sulmet Kibernetike nëpërmjet antivirus dhe anti-malware;
- Kapaciteti i rikuperimit pas një incidenti (BCP/DRP);
- Manuale, etj.

Universitetit të Sporteve të Tiranës i rrjedh e drejta për të marrë shërbime nga RASH bazuar në marrëveshjen kuadër lidhur midis UST dhe Rrjetit Akademik Shqiptar (12 mujore në fuqi) nr.863 prot, datë 21.03.2024 “Për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”. Tarifat dhe pagesat e marrëveshjes kuadër nr. 863 prot, datë 21.03.2024 bazohen në vendimmarrjen e Bordit Drejtues të RASH, konkretisht si citohet në marrëveshjen kuadër vendimi nr.1, datë 04.03.2024:

- shërbim software Pitagora: 600 lekë për student;
- shërbim i internetit: 300 lekë për student.

Për vitin 2023 ka qenë në fuqi marrëveshja kuadër lidhur midis palëve me nr. 336 prot, datë 30.01.2023 “Për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”.

Për periudhën 2023-2024 shërbimet e cilësuara në marrëveshje janë: sistemi informatik Pitagora, si dhe shërbimi i konektivitetit në internet.

Struktura e IT në UST përbëhet nga 3 punonjës, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialistë. Përshkrimet e punës për këtë strukturë janë pjesë e rregullores së miratuar me vendimin e senatit nr.6, datë 20.01.2025 “Për miratimin e rregullore së brendshme të punës për organizimin dhe funksionimin e administratës së rektoratit të universitetit të sporteve të Tiranës”.

*Detyrat kryesore të kësaj strukture, janë:*

- menaxhimi i rrjetit të brendshëm në institucion dhe shfrytëzimi racional i pajisjeve të Teknologjisë së Informacionit;
- administrimi i përdoruesve në Microsoft Office 365;
- administrimi i përdoruesve në UAlbania;
- administrimi i përdoruesve në Pitagora;
- administrimi i përdoruesve në pajisjet Multifunksionale;
- procedurat backup periodike të sistemeve dhe pajisjeve;
- administron sistemin e menaxhimit për të gjithë ciklin akademik të studimeve universitare;
- menaxhon platformën akademike të zhvillimit të procesit mësimor online;
- publikimi i informacioneve dhe materialeve të ndryshme në faqen zyrtare të UST;
- kujdeset për mbarëvajtjen e programit dhe sistemit të kamerave në ambientet e UST-së;

Nga auditimi mbi dokumentacionin e hartuar në drejtim të sigorisë së informacionit u konstatua se, nuk janë hartuar politika të sigorisë së informacionit, mungesa e të cilës krijon një mjedis të paorganizuar dhe të rrezikuar ndaj sulmeve dhe dëmeve të pakthyeshme për të dhënat.

***Mungesa e politikave të sigorisë së informacionit sjell që:***

- sistemet dhe të dhënat mbeten të pambrojtura ndaj sulmeve si *malware*, *phishing*, *ransomware* dhe akses i paautorizuar.
- rritet mundësia e humbjes së të dhënave kritike, duke përfshirë informacionin konfidencial.
- nuk ka plane të qarta për identifikimin, reagimin dhe rikuperimin nga një incident kibernetik, duke çuar në ndërprerje më të gjata dhe më shumë dëme.
- stafi nuk është i ndërgjegjshëm për rolin e tij në mbrojtjen e sigorisë, gjë që rrit rrezikun e gabimeve njerëzore, si klikimi i linqeve të rrezikshme ose ndarja e informacionit të ndjeshëm.
- krijohen kushte për mosrespektimin e ligjeve dhe rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave dhe sigurinë e informacionit, duke sjellë penalitete dhe pasoja ligjore.
- një incident sigurie i shkaktuar nga mungesa e politikave mund të dëmtojë reputacionin e institucionit dhe të ulë besimin e grupeve të interesit.

*Kontrata e shërbimit me RASH.* Shërbimi i konektivitetit në internet për Universitetin e Sporteve të Tiranës është një nga shërbimet e ofruara nga Rrjeti Akademik Shqiptar, dokumentuar në marrëveshjen ndërmjet dy institucioneve protokolluar në UST me nr.863, datë 21.03.2024.

*Vazhdimësia në ofrimin e shërbimit.* Për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës gjatë situatave të papritura, universiteti është në fazë të hartimit dhe miratimit të Planit të Vazhdimësisë së Ofritit të Shërbimit, me anë të të cilit synohet të ofrohen udhëzime për vazhdimin e operacioneve akademike dhe administrative gjatë dhe pas ndërprerjeve të papritura, duke minimizuar ndikimin në procesin mësimor dhe shërbimet ndaj studentëve.

Objektivat Kryesore të Planit të Vazhdimësisë së Ofrimit të Shërbimit:

- sigurimi i vazhdimësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies;
- minimizimi i kohës së ndërprerjes së shërbimeve universitare;
- mbrojtja e aseteve, të dhënave dhe infrastrukturës së universitetit.

Skenarët e mundshëm të rreziqeve që janë identifikuar nga vetë UST janë:

- ndërprerje energjie;
- dështime të rrjetit ose serverëve;
- sulme kibernetike;
- fatkeqësi natyrore (tërmete, përmbytje);
- humbje aksesi në sistemet e të dhënave;
- ndërprerje të shërbimeve për studentët, pedagogët si dhe administratën.

*Nga auditimi mbi marrëveshjen e hartuar ndërmjet palëve nr.863, prot. datë 21.03.2024, u konstatua se janë përcaktuar tarifatat dhe pagesat nga Bordi Drejtues i RASH me vendimin nr.1, datë 04.03.2024 që është 900 lekë për student tarife vjetore për shërbimin e internetit dhe shërbim software “Pitagora”. Në marrëveshje nuk ka asnjë përcaktim për kohën e kryerjes së pagesës si dhe shpërndarjen e tyre në vlerë. Në praktikën e vitit 2024 shërbimi është paguar i plotë, në datë 25.11.2024 me urdhër shpenzim nr.461, ndërsa në praktikën e vitit 2023 shërbimi është paguar i plotë, në datë 25.03.2024 me urdhër shpenzim nr.110.*

Gjithashtu, në këtë dokument nuk përcaktohen mundësitë e zgjidhjes teknike, si dhe koha e nevojshme për rikthimin e shërbimit, në një rast të papritur ndërprerje i cili mund të ndodhë për arsye të ndryshme. Nuk është e mundur për UST të hartojë një plan vazhdimësie, për sa kohë shërbimet kryesore që janë konektiviteti në internet dhe portali i menaxhimit të studentëve, janë shërbime që ofrohen nga RASH.

Dy institucionet RASH dhe UST kanë përgjegjësi të bëjnë deklaratimet e të dhënave, që përpunojnë, pranë Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të miratojnë rregulloret mbi mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të marrëveshjes ndërmjet tyre në pikat 6.1.i dhe 6.2.d.

Në këtë marrëveshje janë përcaktuar dhe përgjegjësitë për të dhënat në pronësi të UST që përpunon RASH, specifikisht në:

Nenin 14 – Mbrojtja e të dhënave;

Nenin 15 – Transferimi i të dhënave nga RASH në rolin e përpunuesit dhe kontrollorit të tyre;

Nenin 17 – Konfidencialiteti;

Nenin 13 – Pronësia mbi të dhënat.

Megjithëse në marrëveshjet kuadër vjetore cilësohet nevoja për deklarimin e të dhënave te Komisioneri, rregullorja në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale të UST-s, për periudhën objekt auditimi, është miratuar me Vendimin e Senatit nr.28, datë 19.05.2017, protokolluar me shkresën nr.622/15, datë 19.05.2017 dhe nuk është përditësuar deri më tani.

Nga Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, është përcjellë për miratim tek Rektori i UST, përditësimi i rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale me shkresën nr.2393, datë 29.09.2023, si dhe rregulloren për sistemin e monitorimit me video mbikëqyrje në UST me shkresën nr.1425, datë 25.05.2023, të cilat nuk janë miratuar si dokumente dhe nuk janë hartuar me kërkesë të brendshme nga një grup pune.

*Nga auditimi u konstatua se nuk është bërë përditësimi i rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe rregullores për sistemin e monitorimit me video mbikëqyrje në UST, si të nevojshme për rishikim nisur nga ndryshimet në teknologji që janë zhvilluar në institucion.*

*Sistemet operative dhe versionet e tyre (patching & updates).* Bazuar në të dhënat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit, versionet e Sistemit Operative për 123 kompjuterë të vendosur në funksion, rezultuan të jenë si më poshtë:

- Në 39 kompjuterët e Administratës në UST, sistemet operative janë:
  - 10 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 24 kompjuterë me sistem operimi Windows 10
  - 5 kompjuterë me sistem operimi Windows 7
- Në 13 kompjuterët e personelit akademik në Departamentin e Edukimit dhe Shëndetit, sistemet operative janë:
  - 5 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 6 kompjuterë me sistem operimi Windows 10
  - 2 kompjuterë me sistem operimi Windows 7
- Në 9 kompjuterët e personelit akademik në Departamentin e Sporteve Kolektive, sistemet operative janë:
  - 1 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 6 kompjuterë me sistem operimi Windows 10
  - 2 kompjuterë me sistem operimi Windows 7
- Në 11 kompjuterët e personelit akademik në Departamentin e Sporteve Individuale, sistemet operative janë:
  - 5 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 6 kompjuterë me sistem operimi Windows 10
- Në 11 kompjuterët e personelit akademik në Departamentin e Veprimtarisë Fizike, Rekreative dhe Turizimit, sistemet operative janë:
  - 1 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 6 kompjuterë me sistem operimi Windows 10
  - 4 kompjuterë me sistem operimi Windows 7
- Në 9 kompjuterët e personelit akademik në Departamentin e Menaxhimit të Sporteve dhe Turizimit, sistemet operative janë:
  - 2 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 6 kompjuterë me sistem operimi Windows 10
  - 1 kompjuterë me sistem operimi Windows 7
- Në 8 kompjuterët e personelit akademik në Departamentin e Lëvizjes dhe Shëndetit, sistemet operative janë:
  - 1 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 5 kompjuterë me sistem operimi Windows 10
  - 2 kompjuterë me sistem operimi Windows 7
- Në 10 kompjuterët e personelit akademik në Departamentin e Shkencave Biomjekësore dhe Humane, sistemet operative janë:
  - 6 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 3 kompjuterë me sistem operimi Windows 10
  - 1 kompjuterë me sistem operimi Windows 7
- Në 7 kompjuterët e personelit akademik në Departamentin e Kineziologjisë të UST sistemet operative janë:
  - 4 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 2 kompjuterë me sistem operimi Windows 10
  - 1 kompjuterë me sistem operimi Windows 7
- Në 6 kompjuterët e personelit akademik në Departamentin e Rehabilitimit, sistemet operative janë:
  - 3 kompjuterë me sistem operimi Windows 11
  - 1 kompjuterë me sistem operimi Windows 10

- 2 kompjuterë me sistem operimi Windows 7

Nga auditimi mbi sistemet e operimit dhe versionet e tyre, u konstatua se Universiteti i Sporteve të Tiranës, ka në përdorim për administratën dhe stafin akademik:

- 38 kompjuterë me sistem operimi Windows 11 – të cilët aktualisht janë në suport.
- 65 kompjuterë me sistem operimi Windows 10 – të cilët aktualisht janë në suport, që përfundon më 14 tetor 2025. Pas kësaj date, Microsoft nuk do të ofrojë më përditësime sigurie apo përmirësime për këto versione. Për përdoruesit që dëshirojnë të vazhdojnë përdorimin e Windows 10 pas kësaj date, Microsoft do të ofrojë Shërbimin e Përditësimeve të Zgjeruara të Sigurisë (ESU) deri në tetor 2028, me një plan çmimesh vjetore.
- 20 kompjuterë me sistem operimi Windows 7 – aktualisht nuk ofrohen më përditësime sigurie për Windows 7, duke e bërë përdorimin e tij një rrezik të madh për sigurinë.

Nga auditimi u konstatua se, për periudhën objekt auditimit UST nuk disponon një sistem antivirus, çfarë e ekspozon institucionin ndaj kërcënimeve të mundshme kibernetike si *malware*, *trojan* dhe viruse të ndryshme, që mund të rrezikojnë integritetin e sistemeve, humbjen e të dhënave dhe kosto financiare të paparashikuara.

UST nuk ka ndërtuar një Active Directory, si rezultat i pamundësisë financiare për të ndërtuar një ambient fizik sipas standardeve dhe blerjen, instalimin dhe ruajtjen e pajisjeve server si dhe mirëmbajtjen e tyre, sikurse kërkohen nga standardet dhe praktikat me të mira të sigurisë.

Universiteti i Sporteve, ka blerë në nëntor të vitit 2020 shërbimet e Microsoft, për një numër minimal licencash Office 365 Tenant Provisioning me vlerë 400 euro pa TVSH dhe School Data Sync Implementation, me vlerë 120 euro pa TVSH.

Me këtë blerje Universiteti i Sporteve, si institucion arsimor, ka siguruar pa pagesë shërbimet *Office 365 A1 for student* për 5000 përdorues, si dhe *Office 365 A1 for Teachers, Faculty and Staff* për 600 përdorues. Nga llogaria e administratorit të shërbimeve Cloud në Microsoft u vu re se paketa e shërbimit është më e gjerë, ku disa prej tyre janë të rëndësishme, si:

- Azure Active Directory (Azure AD) Basic for Education;
- Azure Rights Management;
- Microsoft Office 365 ku përfshihen Word, Excel Powerpoint, OneNote;
- Office Mobile apps for Office 365;
- Microsoft Teams;
- OneDrive për ruajtjen e të dhënave deri në 1TB;
- Education Analytics;
- Microsoft Planner;
- Whiteboard (Plan 1);
- SharePoint for education;
- Email me Outlook Web App me hapësirë 50GB etj;

Azure Active Directory (Azure AD) Basic for Education është një zgjidhje e menaxhimit të identitetit dhe aksesimit, e ndërtuar posaçërisht për institucionet arsimore. Ky shërbim ndihmon në rritjen e sigurisë, thjeshtimin e aksesit dhe përmirësimin e menaxhimit të përdoruesve që aksesojnë një infrastrukturë rrjeti informatik.

Disa nga funksionalitetet kryesore që ofron janë:

- lehtëson krijimin dhe menaxhimin e llogarive të studentëve, mësuesve dhe stafit, duke përfshirë krijimin automatik të grupeve bazuar në klasa ose departamente.
- lejon përdoruesit të aksesojnë aplikacione të shumta (si Office 365, Microsoft Teams dhe aplikacione të tjera arsimore) me një llogari të vetme (*Single Sign-On - SSO*), duke përmirësuar produktivitetin dhe përvojën e përdoruesit.

- përfshin integritet me sisteme të njohura arsimore dhe ofron mjete për të mbështetur menaxhimin e përdoruesve dhe qasjes bazuar në rolin e tyre (student, mësues ose staf).
- ofron raporte për aksesin e përdoruesve, përdorimin e aplikacioneve dhe aktivitetet e dyshimta, duke ndihmuar në monitorimin e sigurisë dhe përdorimit të burimeve.
- siguron disa mekanizma për të mbrojtur llogaritë e përdoruesve, si ndjekja e tentativave të dyshimta për hyrje dhe bllokimi automatik i hyrjeve nga lokacione të rrezikshme.

*Nga auditimi u konstatua se* Universiteti i Sporteve nuk ka arritur të vejë në përdorim një pjesë të rëndësishme të paketës së shërbimeve të ofruara pa pagesë nga Microsoft, të cilat janë shërbime që jo vetëm lehtësojnë aktivitetin arsimor dhe sigurojnë mjedise moderne të të mësuarit dhe punës, por mundësojnë një ambient më të sigurtë nga ana e sigurisë së informacionit, të cilin vetë universiteti nuk e ka të mundur ta ndërtojë.

Në kuadër të licencimit për institucionet edukative të Office 365, UST ka në dispozicion:

- 600 licenca për staf akademik (faculty), nga të cilat 224 janë aktualisht në përdorim;
  - 5000 licenca për studentë nga të cilat 370 janë aktualisht në përdorim.
- Licencat për stafin akademik ofrojnë qasje të plotë në mjetet e Office 365, duke mundësuar përdorimin e aplikacioneve të njohura si Word, Excel, PowerPoint dhe Outlook, si dhe shërbime të tjera si OneDrive dhe Microsoft Teams për ruajtje të dokumenteve dhe trajnime apo takime online.

Po ashtu, studentët përfitojnë licenca që mundësojnë përdorimin e këtyre mjeteve për qëllime arsimore dhe bashkëpunim në projektet e tyre. Ky licencim ofron mundësi të barabarta për përdorim të teknologjisë moderne në mësimdhënie, duke kontribuar në përmirësimin e cilësisë së edukatës dhe rritjen e produktivitetit.

*Nga auditimi u konstatua se* administrata dhe stafi akademik në UST përdor office të instaluar lokalisht, si dhe pajisje USB për transferimin e materialeve nga një kompjuter në një tjetër, një praktikë kjo që lejon përhapjen e *malware* (sulmet keqdashëse) dhe viruseve nga pajisjet e jashtme apo nga pajisja në pajisje dhe në mënyrë të pashmangshme në të gjithë infrastrukturën, duke rrezikuar integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave.

*Nga auditimi u konstatua se* të gjithë përdoruesit e pajisjeve i aksesojnë si administrator lokal, pra me të drejta të plota për të kryer lirshëm veprime, mes tyre dhe instalime të ndryshme *software* pa nevojën e një aprovimi paraprak, çfarë cenon sigurinë e të dhënave në këto pajisje dhe në rrjetin e brendshëm.

Në bazë të Marrëveshjes për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në teknologjinë e informacionit që është lidhur me RASH, për Universitetin e Sporteve të Tiranës janë vënë në dispozicion IP publike xx.xxx.xxx.xx për internetin dhe IP publike xx.xxx.xxx.xx për serverin e katalogut online të Bibliotekës së Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Ndërsa IP reale e faqes Web të universitetit është e kompanisë tek e cila bëhet hostimi është xxx.xx.xxx.xxx.

Për skanimin e IP reale, u përdor *Shodan* i cili është një mjet i njohur për ekspertët e sigurisë kibernetike, për të identifikuar vulnerabilitete të ekspozuara në internet dhe analizimin e konfigurimeve të rrjeteve. Me anë të tij gjenden dhe analizohen informacione rreth pajisjeve duke përdorur të dhëna si portat e hapura, shërbimet që ofrohen nga pajisja, dhe informacionin mbi versionet e software-ve që përdoren.

Nga skanimi i IP xx.xxx.xxx.xx së internetit u konstatua se janë të hapura portat:

xxx - Për portën xxx rezulton se serveri përdor versionin **NTPv3**, që është një version i vjetër i protokollit.

xxx - Për portën xxx është konfiguruar SNMPv3 i cili është versioni më i sigurt i SNMP, sepse ofron **autentifikim** dhe **kriptim** për të mbrojtur komunikimin.

Nga skanimi i IP xx.xxx.xxx.xx të serverit të katalogut online të Bibliotekës së Universitetit të Sporteve të Tiranës u konstatua se janë të hapura portat: xx, xxxx, xxxx, xxxx, xxxx, xxxx, xxxx dhe xxxxx.

Serveri përdor versionin Apache httpd x.x.x i cili është i ekspozuar ndaj disa vulnerabiliteteve me risk të lartë si CVE-xxxx-xxxxx, CVE-xxxx-xxxxx, CVE-xxxx-xxxxx, CVE-xxxx-xxxxx, si dhe vulnerabilitete të tjera me risk të mesëm.

Nga skanimi i IP xxx.xx.xxx.xxx së faqes Web të universitetit e cila është e hostuar tek një Operator Ekonomik, u konstatua se janë të hapura portat: xx, xx, xxx, xxx, xxxx, xxxx, xxxx, xxxx, xxxx, xxxx dhe xxxx.

Operatori Ekonomik hostues i faqes web të UST, përdor teknologjinë HTTP/3 e cila është gjenerata më e fundit e protokollit HTTP, megjithatë nga skanimi u konstatua ekspozim ndaj disa vulnerabiliteteve me risk të lartë si CVE-xxxx-xxxxx, CVE-xxxx-xxxx, si dhe vulnerabilitete të tjera me risk të mesëm.

*Për arsye sigurie, evidencat e siguruara nga skanimi janë përcjellë tek personi i kontaktit njëherazi dhe drejtori për IT.*

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi Projektraportin.*

## **2.2 Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output**

Në zbatim të pikës 2 “*Auditimi i sistemeve informatike mbi të dhënat Input/Output*” të Programit të Auditimit janë shqyrtuar dhe vëzhguar nga afër sistemet informatike mbi të dhënat Input/Output si dhe dokumentacioni udhëzues, për mbarëvajtjen dhe funksionimin e tyre si:

- Historiku dhe përshkrim i përgjithshëm i sistemit Pitagora;
- Statuti i Universitetit të Sporteve të Tiranës;
- Rregullorja e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së UST-ës;
- Rregullore e brendshme e sistemit;
- Komunikimet shpresore mbi funksionalitetet e sistemit;
- Të dhënat hyrëse dhe dalëse;
- Demonstrim i roleve nga përdorues të ndryshëm për tu njohur me funksionalitetet e sistemit dhe rrjedhën e informacionit;
- Aktet rregullative që lidhen me sistemin;
- Informacion mbi veprimet operacionale brenda dhe jashtë sistemit;
- Intervista të drejtpërdrejta me punonjës që kanë role në sistem, etj.


Objektivi i auditimit të sistemeve dhe kontrolleve të aplikacioneve, për të dhënat Input / Output që Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST) ka në administrim apo përdorim, është vlerësimi mbi efektivitetin dhe eficiencën e proceseve të automatizuara të punës në funksion të objektit të veprimtarisë të institucionit.

UST ka pasur një zhvillim të rëndësishëm në integrimin e teknologjisë së informacionit (TI) gjatë dekadës së fundit, proces ky i domosdoshëm për të mbështetur mësimdhënien, kërkimin shkencor dhe administratën me teknologjinë bashkëkohore.

Në vitin akademik 2020 - 2021 UST filloi të përdorte sistemin Pitagora, sistem i zhvilluar dhe i mirëmbajtur nga Rrjeti Akademik Shqiptar (RASH).

Sistemi Pitagora është sistem web – based, i krijuar nga RASH (SaaS- Software as a Service) dhe i aksesueshëm nga përdoruesit nëpërmjet url: <https://UST.pitagora.rash.al>. Ky sistem përdoret për menaxhimin e studimeve dhe të kurrikulës në shërbim të marrëdhënies Staf akademik - Student - Institucion. Sistemi lehtëson veprimtarinë e UST në disa drejtime si: administrimi i didaktikës, ofertës akademike / karrierës së studentit / provimeve dhe notave, administrim të studentëve hyrës dhe dalës, etj.

Fig1: Ndërfaqja hyrëse në sistemin Pitagora



Burimi: Sistemi Pitagora

Universitetit të Sporteve të Tiranës i rrjedh e drejta për të qenë përdorues i sistemit Pitagora nga marrëveshja kuadër lidhur midis UST dhe Rrjetit Akademik Shqiptar me qëllim ofrimin e disa shërbimeve dhe produkteve në fushën e teknologjisë së informacionit. Marrëveshja kuadër lidhur midis UST dhe Rrjetit Akademik Shqiptar (12 mujore në fuqi) nr. 863 prot, datë 21.03.2024 “Për ofrimin dhe përfitimn e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”. Tarifat dhe pagesat e marrëveshjes kuadër nr. 863 prot, datë 21.03.2024 bazohen në vendimmarrjen e Bordit Drejtues të RASH, konkretisht si citohet në marrëveshjen kuadër vendimi nr.1, datë 04.03.2024:

- Shërbim software Pitagora: 600 lekë për student;
- Shërbim i internetit: 300 lekë për student.

Për vitin 2023 ka qenë në fuqi marrëveshja kuadër lidhur midis palëve me nr. 336 prot, datë 30.01.2023 “Për ofrimin dhe përfitimn e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”.

**Përdoruesit (user) e sistemit dhe rolet e tyre.** Sistemi Pitagora ofron mundësinë për dhënie e rolit të përdoruesit sipas detyrave funksionale të tij. Çdo përdorues ka akses sipas rolit përkatës në sistem. Zgjidhja aktuale e sistemit web - based mundëson aksesimin nga të gjithë përdoruesit nëpërmjet çdo pajisje që ka qasje në internet, pa pasur nevojë për instalime të programeve specifike.

Sistemi përdoret nga stafi akademik, për pasqyrimin e rezultateve dhe përpilimin e procesverbaleve, përdoret nga studentët për informimin e tyre lidhur me aktivitetin akademik në universitet (kalendarët, provimet, notat, njoftimet, etj.). Administrimi i prurjeve të reja (studentëve të rinj të ciklit të parë të studimeve “bachelor”) në Universitetin e Sporteve të Tiranës realizohet përmes portalit U - Albania (portali i aplikimit universitar, në të cilin

maturantët aplikojnë dhe regjistrohen në programe studimi) dhe ndërlidhjes së këtij portali me sistemin Pitagora, të vëna në dispozicion nga RASH.

*Përdoruesit e sistemit janë:*

- Sekretaria Mësimore (kryesekretarja, sekretaret e fakulteteve);
- Pedagogët;
- Studentët;
- Dega e Burimeve Njerëzore;
- Zyra e Kurrikulave;
- Specialist IT;
- Zyra e Financës;
- Specialist Departamenti.

*Sekretarja e fakultetit:*

- Kontrollon të dhënat e studentëve mbasi RASH bën kalimin në Pitagora nga sistemi U-Albania;
- Ndan studentët në grupe sipas programeve të studimit dhe kontrollon shpërndarjen e tyre për çdo grup;
- Aktivizon dhe ngarkon në sistem para provimit studentët sipas lëndëve dhe programeve të studimit përkatëse;
- Kontrollon plotësimin e Komisioneve të Provimeve;
- Kryen ndërrimin e programit të studimit brenda universitetit;
- Konfirmon kërkesat për diplomim dhe mbyll karrierat e studentëve me arsye si diplomim, largim, transferim etj.;
- Komunikon me RASH mbi ndryshimet në kushtet e regjistrimit në provime për çdo sezon;
- Dërgon kërkesa për suport në helpdesk@rash.al.

*Kryesekretarja*

- Kontrollon të dhënat e studentëve mbasi RASH bën kalimin në Pitagora nga sistemi U-Albania;
- Ndan studentët në grupe sipas programeve të studimit dhe kontrollon shpërndarjen e tyre për çdo grup;
- Aktivizon dhe ngarkon në sistem para provimit studentët sipas lëndëve dhe programeve të studimit përkatës;
- Kontrollon plotësimin e Komisioneve të Provimeve;
- Arkivon procesverbalin e dorëzuar nga pedagogu pas dorëzimit të tij në sekretari;
- Kryen ndërrimin e programit të studimit brenda universitetit dhe ekuivalentimin e notave të ardhura me vendim;
- Konfirmon kërkesat për diplomim dhe mbyll karrierat e studentëve me arsye si diplomim, largim, transferim etj.;
- Komunikon me RASH mbi ndryshimet në kushtet e regjistrimit në provime për çdo sezon;
- Dërgon kërkesa për suport në helpdesk@rash.al.

*Personeli akademik*

- Shikon online orarin dhe grafikun e provimeve;
- Bën frekuentimin e grupeve të studentëve;
- Bën vlerësimin me notë të grupeve të studentëve;
- Bën shqyrtimin deri në 48 orë pas publikimit të notave mbi ankimimet e studentëve në lidhje me rezultatet e tyre;
- Gjeneron dhe publikon online procesverbalet;
- Printon procesverbalet, i firmos dhe i dorëzon në sekretarinë mësimore;

- Për çdo dorëzim apo ndryshim të rezultateve mbas arkivimit të procesverbaleve të provimit, personeli akademik duhet fillimisht ti drejtohet me shkresë dekanit të fakultetit.

#### *Studenti*

- Shikon notat dhe kreditet e lëndëve tek menuja “*Libreza e Notave*”;
- Shikon faturat dhe ka mundësi t’i shkarkojë tek menuja “*Pagesat*”;
- Duhet të kryejë brenda afatit pagesën e tarifës së shkollimit, për të mos u penalizuar në lidhje me futjen e tij në provime;
- Informohet mbi kurrikulën e detajuar mësimore tek menuja “*Plan Programi*”;
- Shikon grafikun dhe datat e provimeve;
- Regjistrohet në provime tek menuja “*Provime*”.

#### *Spektori i Burimeve Njerëzore*

- Krijon kredencialet për stafin e ri akademik të brendshëm;
- Krijon kredencialet për stafin e ri akademik me kontratë;
- Dërgon kërkesa për suport në helpdesk@rash.al.

*Shënim:* Në mënyrë që mos të ketë dublikime të të dhënave duhet që të pasqyrohen të dhënat e sakta. Sistemi bllokun regjistrimin e një useri dy herë duke përdorur të njëjtën kartë ID.

#### *Spektori i Zhvillimit të Kurrikulave;*

- Kopjon kurrikulën;
- Rinovon kurrikulën e programeve të studimit të viteve paraardhëse;
- Pasqyron ndryshimet e kurrikulës së re;
- Dërgon kërkesa për suport në helpdesk@rash.al.

*Shënim:* Nga kryerja e saktë dhe në kohë e hapave të mësipërm varet dhe funksionimi i këtij programi mësimor.

#### *Specialist IT*

- Asistojnë stafin akademik në përdorimin e sistemit;
- Asistojnë stafin administrativ në përdorimin e sistemit;
- Asistojnë studentët në përdorimin e sistemit;
- Mbajnë kontakt të vazhdueshëm me specialistët e RASH;
- Dërgojnë kërkesa për suport në helpdesk@rash.al.

#### *Spektori i Shërbimeve Financiare*

- Informon RASH në lidhje me vendimin e tarifave për vitin akademik dhe rastet e përjashtimit;
- Pasqyron në sistem pagesat e studentëve në lidhje me tarifën e shkollimit para sezonit të provimeve dhe vë në dijeni sekretarinë mësimore me qëllim përditësimin e të dhënave të listës së studentëve në provimin përkatës (nëse ka pasqyrime pas afatit të përcaktuar);
- Pasqyron në sistem studentët e përjashtuar nga tarifatat sipas vendimeve të Bordit të Administrimit;
- Pasqyron në sistem faturat e pagesave të kryera nga studenti;
- Kontrollon faturat e afishuara me kuotat përkatëse.

#### *Specialistët e Departamenteve*

- Pasqyrojnë sezonet / grafikun e provimeve;
- Pasqyrojnë Komisionet e Provimeve.

Nga praktika, çdo përdorues i një roli të caktuar, në rast problematike me sistemin, e përcjellë këtë problematikë me email te adresa e suportit e RASH helpdesk@rash.al. Për zgjidhjen e secilës nga problematikat e raportuara, monitorimi bëhet nga vetë përdoruesi që e ka raportuar. Duke qenë se çdo rol mund të adresoj problematika dhe kërkesa për suport në helpdesk@rash.al,

menaxhimi i këtyre kërkesave dhe monitorimi i zgjidhjes së problematikave bëhet më i vështirë. Nga auditimi është konstatuar se institucioni nuk ka një person/persona të autorizuar për ndjekjen e zbatimit të marrëveshjes kuadër me RASH, rrjedhimisht dhe problematikave të hasura gjatë punës në sistem, në kundërshtim me pikën 5, nënpika e) e kësaj marrëveshje “Universiteti ka të drejtë të kontaktojë në çdo moment RASH me anë të personave të autorizuar nga institucioni për monitorimin e realizimit të procesit/proceseve objekt i kësaj marrëveshje”.

Tabela 1: Userat e sistemit për periudhën objekt auditimi

VITI AKADEMIK	Nën-ndarja	Përdorues
	2022 - 2023	<b>Cikli i parë i studimeve Bachelor</b>
Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes		542 studentë
Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit		559 studentë
Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit		186 studentë
<b>Cikli i dytë i studimeve Master i Shkencave</b>		
Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes		248 studentë
Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit		31 studentë
<b>Cikli i dytë i studimeve Master Profesional</b>		
Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes		220 studentë
Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit		45 studentë
<b>Personeli me kohë të plotë</b>		
Personeli akademik		101 përdorues
Personel ndihmës akademik dhe administrativ		13 përdorues
<b>Personeli me kohë të pjesshme</b>		
Personeli akademik		12 përdorues
2023 - 2024	<b>Cikli i parë i studimeve Bachelor</b>	
	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	595 studentë
	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	599 studentë
	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	224 studentë
	<b>Cikli i dytë i studimeve Master i Shkencave</b>	
	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes	438 studentë
	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	43 studentë
	<b>Cikli i dytë i studimeve Master Profesional</b>	
	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit	35 studentë
	Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit	21 studentë
	Programi i Studimit të Formimit të Vazhduar në fushën psiko-pedagogjike	11 studentë
	<b>Personeli me kohë të plotë</b>	
	Personeli akademik	104 përdorues
	Personel ndihmës akademik dhe administrativ	13 përdorues
	<b>Personeli me kohë të pjesshme</b>	
Personeli akademik	18 përdorues	

Burimi: Të dhëna nga UST, përpunuar nga grupi i auditimit

### Procedura e menaxhimit të user-ave

Llogaritë e studentëve të kursit të parë në sistemin Pitagora krijohen nga RASH duke bërë kalimin nga sistemi U - Albania. Studentët e krijuar logohen si fillim me të dhënat si më poshtë:

Username: (shkronja e parë e emrit të studentit. mbiemër i studentit);

Fjalëkalimi: (shkronja e parë e emrit të studentit.mbiemër i studentit).

Studenti në rubrikën e tij ka mundësinë e ndryshimit të fjalëkalimit, por vetë sistemi nuk detyron këtë ndryshim.

Llogaritë e stafit akademik krijohen nga specialisti i burimeve njerëzore. Stafit akademik logohet si më poshtë:

Username: (shkronja e parë e emrit të përdoruesit. mbiemër i përdoruesit);

Fjalëkalimi: Gjenerohet automatikisht nga sistemi Pitagora dhe dërgohet në email.

Tek kategoria “Pedagogët” zgjidhet opsioni “Shto” dhe hapet faqja “Regjistro Pedagog”. Plotësohen saktësisht të gjitha të dhënat e personelit akademik që kërkohet të regjistrohet. Pasi janë plotësuar të gjitha gjeneralitetet, klikohet tek opsioni “Ka dorëzuar dokumenta” dhe më pas bëhet regjistrimi i pedagogut.

Me përfundimin e marrëdhënieve të punës me Universitetin e Sporteve të Tiranës, specialisti i burimeve njerëzore bën çaktivizimin e përdoruesit “Pedagog” nga sistemi Pitagora.

*Disa nga funksionalitetet kryesore janë:*

- **Hapësira didaktike:** Struktura akademike; Menaxhimi i karrierës së studentit; Provime dhe Tema e Diplomës.
- **Hapësira administrative:** Pranimi dhe regjistrimi; Orari dhe provimet; Menaxhimi i studentëve.
- **Tarifat:** Menaxhimi i tarifave të studimit; Bursa për studentët; Periudha Financiare.
- **Diplomimi:** Provimet e shtetit; Praktika studentore; Diploma online dhe suplementi.

Sistemi Pitagora është një sistem i host-uar në data-centerin e RASH. Databaza dhe infrastruktura mbështetëse e sistemit administrohet nga RASH.

Nga auditimi është konstatuar se UST nuk disponon një përdorues me të drejta administrative për sistemin Pitagora dhe nuk ka një urdhër titullari për caktimin e një punonjësi me këto të drejta, në kundërshtim me Marrëveshjen Kuadër nr. 863 prot, datë 21.03.2024 “Për ofrimin dhe përfitimimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”, pika 6: “Detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve”, nënpika 6.2: “UST detyrimet dhe përgjegjësitë”, shkronja b) ku citohet se: “UST ka përgjegjësi të autorizojë një person të administratës së UST në pozicionin e administratorit të Sistemit të Menaxhimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës (SMUST)”. Mungesa e këtij përdoruesi sjell kufizime, vonesa dhe mangësi administrative të veprimeve që kryhen dhe monitorohen nëpërmjet sistemit.

Gjithashtu, është konstatuar se UST nuk disponon diagramë të rrjedhës së informacionit (workflow) nëpërmjet sistemit Pitagora, sikurse përcaktohet në Standardin ISO/IEC 27001:2022, dhe praktikat më të mira të menaxhimit të proceseve të informacionit. Mungesa e tij çon në vështirësi të gjurmimit ku nisnin dhe përfundojnë proceset e automatizuara, si dhe në vështirësinë e identifikimit se cilat hallka kanë nevojë për përmirësim, në funksion të arritjes së qëllimeve të përdorimit të sistemit në proceset e punës së institucionit.

Me anë të shkresës nr. 428 prot, datë 05.12.2024, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore përcjellë për miratim “Rregulloren e Portalit Universitar Pitagora” në vijim të digjitalizimit dhe automatizimit të proceseve të punës të sekretariatit mësimor dhe përdoruesit fundor (student, pedagog etj.). Rregullorja është ende në formë drafti dhe vazhdimisht në ndryshim.

Sipas Marrëveshjes Kuadër nr. 863 prot, datë 21.03.2024 “Për ofrimin dhe përfitimimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”, pika 6: “Detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve”, nënpika 6.2: “UST detyrimet dhe përgjegjësitë”, pika c), përcaktohet se: “UST ka përgjegjësi të miratojë rregulloren e posaçme të SMUST brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e marrëveshjes”. Statuti i Universitetit të Tiranës 2022, neni 23. “Funksionet e rektorit”, pika k) përcakton se: “Kur e çmon të arsyeshme dhe të nevojshme, ngre grupe pune me qëllim kontrolli, studimi apo veprimtari të tjera të veçanta”. Nga auditimi është konstatuar se nuk është ngritur një grup pune me urdhër të brendshëm për hartimin e rregullores për sistemin Pitagora, një kërkesë kjo e dakordësuar dhe cituar dhe në marrëveshjen kuadër . Duke marrë në konsideratë se në marrëveshjen kuadër shprehet qartë se ajo hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj, afati 6 mujor për miratimin e rregullores për përdorimin e sistemit Pitagora është tejkaluar.

*Të dhënat input që popullojnë sistemin:*

- Të dhënat që hidhen në sistem për stafin akademik gjatë regjistrimit fillestar janë: Emri / Mbiemri / Atësia / Numri personal / E-mail / Gjinia / Vendlindja / Titulli akademik, etj.
- Të dhënat që hidhen në sistem për studentin janë: Emri / Mbiemri / Atësia / Numri personal / Numri i matrikullimit / E-mail / Data e regjistrimit / Gjendja e studentit etj.;
- Jo të detyrueshme janë: Rrethi / Komuna / Shkolla e mesme / Mesatarja e shkollës së mesme VKM / ID e maturës / Nr. i matrikullimit të universitetit, etj.

*Politikat dhe kontrollet që sigurojnë saktësinë dhe plotësinë e outputit:*

- Mbas kalimit të maturantëve fitues në fakultetet e UST, kalim ky që bëhet nga ana e RASH nga sistemi U-Albania në sistemin Pitagora, të dhënat e studentëve kontrollohen nga sekretaret e fakulteteve përkatëse manualisht;
- Studentët nuk mund të futen në provimet e sezonit nëse nuk kryejnë pagesën e tarifës vjetore; Sektori i financës verifikon në sistem që pagesa është kryer në momentin që studenti bën pagesën;
- Kalimi i studentëve nga njëri vit akademik në vitin tjetër bëhet nga RASH në përputhje me rregulloren e UST, duke patur parasysh kreditet që i duhen studentëve për kalimin. Mbasi bëhet kalimi, të dhënat e studentëve kontrollohen nga sekretaret e fakulteteve përkatëse;
- Studenti për t'u futur në sezonin e diplomës, duhet të ketë marrë të gjitha provimet dhe të ketë kryer të gjitha pagesat;
- Mbas ngarkimit të notës së provimit të përfundimit në sistem, sekretaria bën mbylljen në sistem për çdo student dhe studentit i shfaqet fatura e diplomimit.

Për të përmbushur nevojat e saj për gjenerim raportesh apo shtim / ndryshim funksionalitetesh, UST dërgon shkresë pranë RASH. Konkretisht, UST me shkresën nr. 3402 prot, datë 15.11.2024, me lëndë: *“Krijimi i disa funksionaliteteve mbi kalueshmërinë dhe notën mesatare, në zbatim të marrëveshjes kuadër për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”*, i drejtohet RASH për gjenerim evidencash.

**Për sekretarët:**

- Gjenerim evidencash mbi kalueshmërinë dhe notën mesatare të kurseve dhe cikleve të ndryshme të fakultetit që mbulojnë;
- Gjenerim evidence për të gjithë studentët me numrin e krediteve të marra si dhe notën mesatare.

**Për stafin akademik:**

- Fleta e procesverbalit do të ketë edhe kalueshmërinë dhe notën mesatare të atij grupi studentësh.

Këto funksionalitete janë në proces realizimi nga RASH. Sipas pikës 5 të marrëveshjes, nënpika e), marrim informacionin se: *“Universiteti ka të drejtë të kontaktojë në çdo moment RASH, me anë të personave të autorizuar nga institucioni për monitorimin e realizimit të procesit / proceseve objekt i kësaj marrëveshje”*.

Nga auditimi i kërkesave për përmirësim në sistemin Pitagora, nga auditimi është konstatuar se marrëveshja nuk përcakton një afat brenda të cilit RASH duhet të vlerësoj dhe të reflektoj ndryshimet që UST kërkon të realizohen në sistem, përsa i përket funksionaliteteve, raporteve të gjeneruara dhe të tjera nevoja që institucioni mund të ketë lidhur me automatizimin e proceseve të punës nëpërmjet sistemit, ose penalitete në rastin e mos realizimit të tyre.

Grupi i auditimit testoi në Sistemin Pitagora rolet e sekretarisë mësimore (roli i sekretares dhe kryesekretares), rolin e specialistit të sektorit të zhvillimit të kurrikulave dhe rolin e IT.

Sekretaritë mësimore kontrollojnë të dhënat e studentëve të importuar nga sistemi U- Albania deri në datë 25 nëntor të çdo viti akademik. Moduli i sekretarive mësimore ka rubrikat: Arkivat/ Autorizime orari / Elementet e Vlerësimit / Elementet mësimor / Grupe programi / Grupet sipas viteve / Krijoi Orar / Kurrikula Nënë / Lëndët / Pedagogët / Periudha studimit / Përdoruesit / Tipe evidencash / Transferime të brendshme / Transferime të jashtme / Tipologjia.

Fig. 2: Ndërfaqja e sistemit për regjistrimin e studentëve

Burimi: Sistemi Pitagora

Kur klikohet te rubrika “Studentët”, shfaqet lista me gjithë studentet me të dhëna: Emër / Mbiemër / Nr. matrikulli / E-mail / Program studimi, etj.

Fig. 3: Ndërfaqja e sistemit me të dhënat e studentëve

Nr.	Foto	Nr. matrikulli	Emri	Atësia	Mbiemri	Email	Programi studimi	Veprimet	Detaje
1		VFR [redacted]	Ab [redacted] Ed [redacted] Ta [redacted]			b [redacted]@hotmail.it	BA Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] - 2014	:	
2		VFR [redacted]	Ab [redacted] Se [redacted] Di [redacted]			a [redacted]@gmail.com	BA Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] - 2022	:	
3		EF8 [redacted]	Ab [redacted] Si [redacted] Gj [redacted]			a [redacted]@hotmail.com	MSC Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti [MSC] - 2015	:	
4		VFR [redacted]	AD [redacted] FA [redacted] Ç [redacted]			d [redacted]@gmail.com	BA Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] - 2019	:	
5		K05 [redacted]	AD [redacted] FA [redacted] Ç [redacted]			A [redacted]@gmail.com	MP 60 Menaxhim në Sport dhe Turizëm [MP] - 2022	:	
6		VFR [redacted]	Ad [redacted] Sc [redacted] La [redacted]			a [redacted]@gmail.com	BA Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] - 2014	:	
7		AFR [redacted]	Ad [redacted] Sc [redacted] La [redacted]			a [redacted]@gmail.com	MP Aktiviteti Fizik dhe Rekreacioni- Trajner Fitnessi [MP] - 2017	:	
8		VFR [redacted]	Ad [redacted] Sc [redacted] Gj [redacted]			g [redacted]@gmail.com	BA Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] - 2016	:	
9		VFR [redacted]	Ad [redacted] Vi [redacted] Va [redacted]			a [redacted]@gmail.com	BA Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] - 2021	:	
10		VFR [redacted]	Ad [redacted] Gj [redacted] M [redacted]			m [redacted]@maturanti.al	BA Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] - 2023	:	

Burimi: Sistemi Pitagora

Nga auditimi është konstatuar se për të marr informacion mbi kreditet dhe notën mesatare të studentëve, roli “sekretar” duhet të klikoj mbi rekordin e çdo studenti në mënyrë individuale. Sekretariati i kontrollon një për një studentët, për të parë notën mesatare dhe kreditet, të cilat përcaktojnë më pas dhe tarifën studimore që studenti duhet të paguajë dhe dorëzojë pranë financës për të kaluar në vitin tjetër akademik.

Fig. 4: Ndërfaqja e studentit me të dhëna mbi notat, mesataren dhe kreditet

TE TIRANES

FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT

A [REDACTED] VFRA0 [REDACTED] J [REDACTED] (BA - VFR-A Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] 2014)

Libreza e notave Orari Vitet e Studentit

**Libreza e notave**

Mesatarja: 5.64  
Kreditet e marra: 180  
Kreditet e pamarra: 0

Për të parë historikun e notave klikoni mbi emërtimin e Lëndës

Viti III  
Mesatarja:5.42; Kreditet e marra:60; Kreditet e pamarra:0

Tipologjia	Kodi i Lëndës	Emërtimi i Lëndës	Nota	Kreditet	Gjendja	Ekviv.	E shlyer	Shto Note
Sem. II	VFRA17A	Menaxhim Aktivitetit Fizik e Sportit	5	10	Kaluar	—		
Diplomë	VFRA20	Provim i Përgjithshëm Përfundimtar	6	6	Kaluar	—		
Nënë	VFRA12	Menaxhim Biznesi	6.4	10	Kaluar	—		
Bijë e VFRA12	VFRA12A	Ekonomi - Financë	7	3	Kaluar	—		
Bijë e VFRA12	VFRA12B	Organizim i Aktivitetit Fizik Rekreacion e Turizëm	5	3	Kaluar	—		
Bijë e VFRA12	VFRA12C	Menaxhim - Marketing Aktivitet Fizik e Sport	7	4	Kaluar	—		
Nënë	VFRA10	Mjeksi Sportive	5.0	9	Kaluar	—		

11:22:54 AM  
10/2/2025

Burimi: Sistemi Pitagora

Në aneksin II të marrëveshjes kuadër lidhur me RASH, pika “Disa nga rolet dhe detyrat”, nën-pika j), përcaktohet se: “Sekretaria mësimore ka përgjegjësi të pajisë në kohë reale studentët me vërtetime studentore”. Në varësi të momentit kur këto vërtetime kërkohen, ato jo gjithmonë kanë të shfaqur numrin e saktë të matrikullit të studentit. Shpesh herë ato shfaqin një kod identifikues të gjeneruar nga vetë sistemi. Arsyeja, siç bëhet me dije nga sekretaret e fakulteteve, është sepse mund të ketë vonesa nga ana e QSHA-së për pajisjen e studentëve me numër matrikulli dhe përcjelljen e informacionit pranë UST-së.

Nga auditimi është konstatuar se tek formati i vërtetimit të notave i gjeneruar nga sistemi, nuk është përfshirë përlllogaritja dhe shfaqja e notës mesatare të kurrikulës nënë, por vetëm të lëndëve përbërëse të asaj kurrikule (bija), e cila në vetvete nuk përbën impakt mbi procesin e pajisjes me vërtetim notash. Gjithashtu, grupi i auditimit konstatoi se në vërtetimin e notave në përmblyllje të gjithë ciklit të studimit (ku pasqyrohen notat e të gjitha viteve) dhe te suplementi, notat dhe kreditet nuk gjenerohen nga sistemi, por plotësohen manualisht nga sekretariati. Plotësimi i të dhënave manualisht, kur ato mund të gjenerohen nga sistemi, rrit mundësinë e gabimeve njerëzore, ul eficiencën e procesit dhe kërkon më shumë kohë për përpunimin e informacionit. Gjithashtu, ndikon në cilësinë dhe saktësinë e të dhënave, duke cenuar integritetin dhe besueshmërinë e informacionit.

Sistemi ka simbolin “\*” (Required Field Indicator) për fushat e detyrueshme për plotësim dhe nuk lejon kalimin në hapat e mëtejshëm pa u plotësuar informacioni i nevojshëm në hapin aktual.

Gjithashtu, roli sekretariatit ndjek dhe procesin e transferimit të studenteve. Transferimi i studentëve mund të jetë i brendshëm ose i jashtëm. Transferimi i brendshëm, pra kur bëhet kalimi i studentëve nga një program studimi te tjetri, realizohet duke klikuar “Shto” te rubrika “Transferime të brendshme” dhe të dhënat plotësohen manualisht sipas regjistrit fizik. Kjo ndërfaqe shfaq të dhëna identifikuese të studentit si: Nr. matrikulli / Emër / Mbiemër / Programi burim / Programi Destinacion. Për studentët me transferime të jashtme vijnë të dhënat nga RASH nëpërmjet portalit U - Albania.

Fig. 5: Ndërfaqja me të dhëna mbi Transferime të Brendshme të studentëve

Nr. matriculli	Emri	Mbiemri	Programi burim	Programi destination	Modifiko	Fshi
EF81	A	K	Part time Shkencat e Lëvizjes (me kohë të gjeshme) [BA] -2013	Bachelor Shkencat e Lëvizjes [BA] -2013		
EF81	A	A	Part time Shkencat e Lëvizjes (me kohë të gjeshme) [BA] -2013	Part time Shkencat e Lëvizjes (me kohë të gjeshme) [BA] -2014		
SHL	E	S	Bachelor Shkencat e Lëvizjes [BA] -2013	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2013		
VFR	M	M	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2015	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2016		
VFR	A	N	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2015	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2016		
EF81	L	C	Bachelor Shkencat e Lëvizjes [BA] -2014	Bachelor Shkencat e Lëvizjes [BA] -2015		
VFR	A	N	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2014	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2015		
VFR	E	H	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2017	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2019		
VFR	E	K	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2021	Bachelor Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA] -2022		
MEFAP G00000154	G	K	Master Profesional Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar -2021	Master i shkencave Mësuesi në Edukimin Fizik dhe Shëndetësor -2023		
EF81	K	R	Part time Shkencat e Lëvizjes (me kohë të gjeshme) [BA] -2013	Part time Shkencat e Lëvizjes (me kohë të gjeshme) [BA] -2014		

Burimi: Sistemi Pitagora

Nga auditimi është konstatuar se rubrika “Tipe evidencash” nuk jep informacion dhe nuk mund të gjenerohen raporte apo evidenca nga sistemi. Sipas Aneksit II të marrëveshjes kuadër me RASH, pika “Disa nga rolet dhe detyrat”, nënpika “Sekretaritë Mësimore”, nënpika g), ku përcaktohet se: “Të shkarkojnë statistikën për çdo program studimit (Nr. i studentëve, F, M, Qytet, Moshë etj)”, duhet të jetë i mundur gjenerimi i këtyre statistikave për nevojat e punës së sekretariatit. Mos pasja e mundësisë së gjenerimit të raporteve nga sistemi kufizon transparencën dhe monitorimin e të dhënave, duke vështirësuar marrjen e vendimeve të bazuara në informacion. Gjithashtu, pengon analizën e performancës dhe identifikimin e parregullsive, duke ndikuar negativisht në menaxhimin dhe eficiencën e procesit.

Fig. 6: Ndërfaqja “Evidencat”

Kodi	Emërtimi	Shkarko
Items per page: 50 0 of 0  < >		

Burimi: Sistemi Pitagora

Referuar pikës 13 të marrëveshjes lidhur me RASH, nënpika 13.1, shkronja c), marrim informacionin se: “Çdo fillim muaji, RASH i dërgon UST-ës një kopje të të dhënave (databazës) në CD/DVD së bashku me shkresën përkatëse”. Nga auditimi i një praktike me përzgjedhje të përcjelljes së një kopje të të dhënave nga RASH në UST, konkretisht atë të muajit tetor 2024, u

konstatua se janë përcjellë të dhënat me shkresën nr. 374, datë 16.10.2024, nga programi i sekretarisë mësimore Pitagora, megjithëse në marrëveshje citohet se do të përcillet një kopje e databazës. Nga verifikimi i të dhënave në CD-në e përcjellë me këto të dhëna për muajin tetor 2024, rezulton se janë vetëm një pjesë e të dhënave që kryesisht kanë të bëjnë me vlerësimin e studentëve dhe jo sikurse përcaktohet në marrëveshje. Gjithashtu, specialistët e IT-së pranojnë se nuk është kryer verifikim dhe kjo detyrë nuk cilësohet në përshkrimet e tyre të punës. Zyra e kurrikulave merr nga përgjegjësit e departamenteve brenda datës 25 shtator të çdo viti akademik planet mësimore të programit të studimit, me të gjitha të dhënat (lëndët, modulet, kreditet, orët e leksionit dhe seminareve, raportin midis tyre, pedagogun e lëndës etj).

Fig. 7: Ndërfaqja “Periudha Studimi”

The screenshot shows the 'Periudha Studimi' (Study Periods) interface. On the left is a sidebar with navigation options: Elementët e Vlerësimit, Elementët Mësimor, Kurrikula nënë, Lëndët, Pedagogët, Periudha studimi (highlighted), and Programe. The main content area has a header with the university logo and name, and a dropdown menu for the academic year (2024-2025) with a '+ Shto' button. Below this is a table with the following data:

Emërtimi	Data e fillimit	Data e mbarimit	Modifiko	Fakulteti	Kushtet	Programet	Fshi	Regjistrimet
Sezon Dimri FSHR	03/02/2025	21/03/2025		FSHRH		+		
Sezon Dimri	24/01/2025	26/03/2025		FSHL		+		
Sezon Dimri	02/02/2025	31/03/2025		FVFR		+		
Sezon Diplomimi (Dimër)	17/02/2025	21/02/2025		FVFR		+		

*Burimi: Sistemi Pitagora*

Moduli i kurrikulave ka rubrikat: Elementet e Vlerësimit / Elementet mësimore / Kurrikula nënë / Lëndët / Pedagogët / Periudha studimi / Programe.

Fig. 8: Ndërfaqja e shtimit të programeve të studimit

The screenshot shows the 'Shtimit të programeve të studimit' (Add Study Programs) interface. On the left is a sidebar with navigation options: Elementët e Vlerësimit, Elementët Mësimor, Kurrikula nënë, Lëndët, Pedagogët, Periudha studimi (highlighted), and Programe. The main content area has a header with the university logo and name, and a dropdown menu for the year (2024) with a '+ Shto' button. Below this is a list of program types under the heading 'Llojet e programeve':

- Program studimi i ciklit të parë Bachelor
- Program studimi i ciklit të parë, me kohë të pjeshme Part time
- Program studimi jouniversitar, profesional 2 vjeçar Jo Universitar Profesional
- Kurse Formimi Kurse Formimi Vazhduar
- Program studimi Master profesional Master Profesional
- Program studimi Master profesional 60 kredite Master Profesional 60 kredite
- Program studimi me cikël unik 5 vjeçar Cikël unik 5 vjeçar
- Program studimi i ciklit të dytë Master i shkencave


On the right, there is a detailed view of a program under the heading 'Programet - Program studimi i ciklit të parë Bachelor'. It shows a table with the following data:

2024	Programet me ** përpara kodit janë programe prioritare			
SHL-A	Shkencat e Lëvizjes [BA]	Shkencat e Lëvizjes [BA]	2024	
SHR-A	Shkenca të Rehabilitimit	Shkenca të Rehabilitimit	2024	
VFR-A	Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA]	Veprimtaria Fizike dhe Rekreacionit [BA]	2024	

*Burimi: Sistemi Pitagora*

Rubrika “Kurrikula Nënë” nëse klikohet në rolin e specialistit të kurrikulës nuk jep informacion. Ky funksionalitet shfaqet i plotësuar në rolin e sekretariatit me qëllim krijimin e lidhjes student-kurrikul studimi. Rubrika “Pedagogët” shfaq informacione për pedagogët, informacion ky i cili nuk përdoret nga Departamenti i Kurrikulave.

Fig. 9: Ndërfaqja e rubrikës “Kurrikula nënë”




Burimi: Sistemi Pitagora

Në rast ndryshimesh të kurrikulave kur studentët transferohen së brendshmi, ndryshimet janë funksionale nëpërmjet sistemit.

Përsa i përket rolit të IT-së në sistem, ky rol asiston përdoruesit në raste problematikash në login (problematika që lidhen me e-mailin e përdoruesit ose / dhe fjalëkalimin e tij). Dy rubrikat që përdoren nga ky rol janë: “Student” dhe “Pedagog”.

Fig. 10: Ndërfaqja e rubrikës “Pedagogët”



Burimi: Sistemi Pitagora

Nga auditimi i ndërfaqes së përdoruesit për rolin IT është konstatuar se shfaqen rubrika të tjera që i takojnë sekretariatit dhe janë të panevojshme ti shfaqen këtij roli, pasi nuk janë objekt i detyrave dhe përgjegjësisë të tij. Shfaqja e funksionaliteteve që nuk i takojnë punës së përdoruesit rrit rrezikun e aksesit të paautorizuar në të dhëna ose procese të ndjeshme. Kjo mund të shkaktojë manipulim të paqëllimshëm ose keqpërdorim të informacionit. Gjithashtu, bie në kundërshtim me parimin e “privilegjeve minimale” (përdoruesi duhet të ketë vetëm nivelin minimal të aksesit dhe privilegjeve që i nevojiten për të kryer detyrat e tij, duke kufizuar qasjen në funksionalitete ose të dhëna që nuk janë të domosdoshme për punën e tij), duke cenuar sigurinë dhe integritetin e sistemit.

Procedurat që ndiqen për ndryshimin e të dhënave kur është e nevojshme janë si më poshtë:

- *Ndryshimi i kredencialeve nga ana e IT për studentët:*

Në momentin që studenti ka probleme me log-in prej e-mail adresës që ka vendosur, ai vë në dijeni IT, duke u paraqitur në zyrën e tij ose duke dërguar email. IT ndryshon adresën e e-mail nëpërmjet opsionit “Gjenero Kod”. Adresa e re e e-mail duhet të jetë aktive, pasi kur ndodh ndryshimi i e-mail, sistemi dërgon linkun e verifikimit. Në momentin që studenti ka probleme me log-in pasi nuk mban mend fjalëkalimin, ai vë në dijeni IT-në, duke u paraqitur në zyrën e tij ose duke dërguar email. IT bën të mundur gjenerimin e një fjalëkalimi të ri, i cili i dërgohet automatikisht në e-mail. Nga auditimi është konstatuar se sistemi në momentin e parë të logimit, pas dërgimit në email të fjalëkalimit të gjeneruar prej tij, nuk të detyron për ndryshimin e këtij fjalëkalimi, duke kompromentuar sigurinë e llogarisë (account) të studentit, në kundërshtim me ISO/IEC 27001:2022 (Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit) (praktikat më të mira për sigurinë, duke përfshirë autentifikimin/identifikimin).

Fig.11: Ndërfaqja “Modifiko Student”

The screenshot shows a web interface for modifying student information. The page title is 'Modifiko Student'. The form contains the following fields:

Emri *	Atësia *	Mbiemri *	Numri personal
A [redacted]	A [redacted]	D [redacted]	K [redacted]
Nr. matriculimit *	Email *	Email Universiteti	Telefoni *
K [redacted]	d [redacted]@gmail.com		6 [redacted]
Data e regjistrimit *	Datëlindja *	Gjendja Civile *	Gjinia *
[redacted] / [redacted] / 20[redacted]	2 [redacted]	Beqar/e	Femër
Adresa *	Vendlindja *	Shtetësia *	Gjendja e studentit
KASHAR	TIRANE	SHQIPTARE	Aktiv
Data e regjistrimit të gjendjes *	Rrethi	Komuna	Tipologji Programi *
[redacted] / [redacted] / 20[redacted]			Degë e parë studimi
Shkolla e mesme *	Shkolla e mesme	Mesatarja e shkolles së m...	Mesatarja e shkolles së m...
100 VJETORI			

Burimi: Sistemi Pitagora

*Ndryshimi i kredencialeve nga ana e IT për stafin.* Në momentin që stafi ka probleme me log in prej e-mail adresës që ka vendosur, ai vë në dijeni IT-në, duke u paraqitur në zyrën e tij ose duke dërguar email. IT-ja bë ndryshimin e adresës së emailit. Adresa e re e e-mail duhet të jetë aktive, pasi kur ndodh ndryshimi i e-mail, sistemi dërgon linkun e verifikimit. Në rastet e problematikave me ndryshimin e fjalëkalimit, IT gjeneron një fjalëkalim të ri, i cili dërgohet automatikisht në email-in e përdoruesit.

*Ndryshimi i kredencialeve nga vetë studenti.* Në momentin që ka probleme me log in pasi nuk mban mend fjalëkalimin, studenti vepron si më poshtë:

- Klikon “Kam harruar fjalëkalimin”;
- Vendos e-mailin;

Sistemi dërgon një e-mail të linkuar ku të jep të drejtën për të vendosur fjalëkalimin e ri; Pas ndryshimit të fjalëkalimit, sistemi ruan ndryshimin dhe identifikimi bëhet nëpërmjet fjalëkalimit të ri.

*Ndryshimi i kredencialeve nga vetë stafi:*

- Klikon “Kam harruar fjalëkalimin”;

- Vendos e-mailin;

Sistemi dërgon një e-mail të linkuar ku të jep të drejtën për të vendosur fjalëkalimin e ri; Pas ndryshimit të fjalëkalimit, sistemi ruan ndryshimin dhe identifikimi bëhet nëpërmjet fjalëkalimit të ri.

Kur studenti kalon nga cikli bachelor në master, email ekzistues bëhet automatikisht jo aktiv, me përjashtim të rasteve kur studenti zgjedh të përdori përsëri këtë email dhe për ciklin master. Në vijim krijohet një llogari e re për studentët që mbyllin një cikël studimesh dhe kalojnë në ciklin master. Kjo llogari krijohet nga RASH me emailin që ka dhënë studenti dhe më pas shfaqen automatikisht llogaritë e reja në sistem.

Fig.12: Demonstrim studenti me llogari bachelor dhe master

Burimi: Sistemi Pitagora

Nga auditimi mbi fjalëkalimin e përdoruesve është konstatuar se sistemi nuk ka skadencë për fjalëkalimet (password expiration), pra sistemi nuk kërkon që përdoruesit të ndryshojnë fjalëkalimet e tyre pas një periudhe të caktuar (p.sh., 90 ditë), gjë e cila komprometon politikat e sigurisë së fjalëkalimit, në kundërshtim me standardin ISO/IEC 27001:2022 (Menaxhimi i Sigurisë së Informacionit). Mos pasja e skadencës së fjalëkalimit rrit rrezikun e aksesit të paautorizuar dhe cenon sigurinë e sistemit. Kjo mund të sjellë përdorimin afatgjatë të fjalëkalimeve të komprometuara dhe mospërputhshmëri me politikat e sigurisë. Si pasojë, institucioni bëhet lehtësisht i cenueshëm ndaj sulmeve kibernetike dhe humbet kontrolli mbi aksesin e të dhënave.

*Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar nuk janë paraqitur observacione mbi Projektraportin.*

## IV. REKOMANDIME

### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi dokumentacionin e hartuar në drejtim të sigurisë së informacionit u konstatua se, nuk janë hartuar politika të sigurisë së informacionit, mungesa e të cilës krijon një mjedis të paorganizuar dhe të rrezikuar ndaj sulmeve dhe dëmeve të pakthyeshme për të dhënat që institucioni gjeneron, përpunon dhe ruan, në kundërshtim me Standardet Ndërkombëtare të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-13 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**1.1 Rekomandimi:** Universiteti Sporteve të Tiranës të marrë masa, për hartimin dhe miratimin e Politikave të Sigurisë së Informacionit, si dokumenti që përcakton rregullat, përgjegjësitë dhe masat për mbrojtjen e të dhënave dhe sistemeve.

*Brenda vitit 2025*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se, Universiteti i Sporteve të Tiranës nuk e ka të mundur të hartojë një plan vazhdimësie, për sa kohë shërbimet kryesore që janë konektiviteti në internet dhe portali i menaxhimit të studentëve, ofrohen nga Rrjeti Akademik Shqiptar. Në marrëveshjen 1 vjeçare hartuar ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Rrjetit Akademik Shqiptar me nr.863, prot. datë 21.03.2024, me objekt “Për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”, u konstatua se nuk janë përcaktuar mundësitë e zgjidhjes teknike si dhe koha e nevojshme për rikthimin e shërbimit, në rast ndërprerje, bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare për menaxhimin e vazhdimësisë së shërbimeve IT.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-13 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**2.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës, në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, të marrin masa për rishikimin e marrëveshjes ekzistuese dhe të përcaktojnë qartë mundësitë teknike, për backup dhe rikthimin e shërbimeve në rast të një ndërprerje të papritur ku të përfshihen:

- Plani i rikuperimit dhe kohës së pritshme për rikuperimin e shërbimit;
- Identifikimin e përgjegjësive të secilës palë në procesin e rikuperimit;
- Vendosjen e mekanizmave për njoftimin dhe koordinimin në rast ndërprerje.

*Brenda vitit 2025*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi sistemet e operimit dhe versionet e tyre, u konstatua se Universiteti i Sporteve të Tiranës, për periudhën objekt auditimi, ka patur në përdorim për administratën dhe stafin akademik:

– 65 kompjuterë me sistem operimi Windows 10 – të cilët janë në suport, që përfundon më 14 tetor 2025. Pas kësaj date, Microsoft nuk do të ofrojë më përditësime sigurie apo përmirësime për këto versione.

– 20 kompjuterë me sistem operimi Windows 7 – për të cilët nuk ofrohen më përditësime sigurie për Windows 7 nga Microsoft, çfarë përbën një rrezik të lartë për sigurinë e informacionit, bazuar në zhvillimet teknologjike të sistemeve të operimit dhe Standardet Ndërkombëtare të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-13 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**3.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës të analizojë dhe të marrë masa duke vlerësuar të gjitha mundësitë teknike, organizative dhe financiare për planifikimin dhe kalimin në Sistemin e operimit Windows 11, për të siguruar që pajisjet e tyre të vazhdojnë të marrin përditësime sigurie nga prodhuesi Microsoft dhe të jenë të mbrojtura ndaj kërcënimeve të mundshme.

*Në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Sporteve të Tiranës nuk disponon sistem antivirus dhe lejon përdorimin e pajisjeve USB për transferimin e materialeve, duke rritur riskun për përhapjen e viruseve, *malware* dhe kërcënimeve të tjera të sigurisë së informacionit. Këto mangësi cenojnë integritetin dhe konfidencialitetin e të dhënave, sikurse përcaktohen në Standardin Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022 dhe Ligjin nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-13 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**4.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës të marrë masa për implementimin e një sistemi antivirus me menaxhim dhe monitorim qendror, si dhe për zbatimin e një politike të centralizuar për menaxhimin e të dhënave, që përfshin kufizimin e përdorimit të pajisjeve USB dhe të drejtave për instalime lokale, me qëllim rritjen e sigurisë dhe mbrojtjen nga kërcënimet kibernetike.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Sporteve nuk ka arritur të vejë në përdorim një pjesë të rëndësishme të paketës së shërbimeve të ofruara (cloud) nga Microsoft, të cilat janë shërbime që lehtësojnë aktivitetin arsimor, sigurojnë mjedise moderne të të mësuarit dhe punës, dhe mundësojnë një ambient më të sigurtë për informacionin, duke qenë se universiteti nuk e ka të mundur të ndërtojë një ambient të tillë. Ky konstatim bazohet në ISO/IEC 27002:2022 – Praktikrat më të mira për kontrollet e sigurisë së informacionit, ku thuhet se institucionet duhet të vlerësojnë dhe adoptojnë shërbime cloud që përmirësojnë sigurinë dhe efektivitetin, sidomos kur burimet e brendshme janë të kufizuara.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-13 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**5.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës duhet të marrë masat për të vënë në përdorim të plotë paketën e shërbimeve të ofruara pa pagesë nga Microsoft, duke përfituar nga avantazhet që ato ofrojnë në aspektin e menaxhimit të mësimdhënies, efikasitetit të punës dhe sigurisë së informacionit.

*Në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se të gjithë përdoruesit i aksesojnë kompjuterat si administrator lokal, pra me të drejta të plota për të kryer lirshëm veprime, mes tyre dhe instalime të ndryshme *software* pa nevojën e një aprovimi paraprak, çfarë cenon sigurinë e të dhënave në këto pajisje dhe në rrjetin e brendshëm, sikurse përcaktohet në Standardin Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022 dhe udhëzimeve në zbatim të tij.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-13 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**6.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës të marrë masa për kufizimin e të drejtave të përdoruesve, duke hequr aksesin e panevojshëm si administrator lokal dhe duke implementuar parimin e privilegjit minimal, duke bërë të mundur që përdoruesit të kenë vetëm të drejtat e nevojshme për kryerjen e detyrave të tyre, ndërsa instalimi i softuerëve duhet të jetë i kontrolluar dhe të kryhet vetëm nga personeli i autorizuar i IT-së.

*Menjëherë*

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe skanimit i IP reale (Internet Protocol), që ka në dispozicion Universiteti i Sporteve të Tiranës, u identifikuan porta të hapura dhe vulnerabilitete për faqen Web dhe shërbimet që ofron Rrjetit Akademik Shqiptar për universitetin, në kundërshtim me praktikrat më të mira në drejtim të sigurisë së informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 7-13 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**7.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës të ndërmarrë masa të menjëhershme për të adresuar tek Rrjeti Akademik Shqiptar, si ofrues i shërbimeve të rrjetit dhe infrastrukturës

dhe tek hostuesi i faqes Web, dobësitë e identifikuar në serverët dhe faqen web, me qëllim trajtim ose korrigjimin e vulnerabilitetëve të konstatuara nga skanimi i IP reale.

*Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Sporteve të Tiranës nuk ka caktuar një punonjës përgjegjës për ndjekjen dhe zbatimin e marrëveshjes me Rrjetin Akademik Shqiptar, në kundërshtim me pikën 5.e) të marrëveshjes nr. 863 prot., datë 21.03.2024. Mungesa e këtij roli ka ndikuar në mos adresimin e problematikave teknike dhe në mungesën e kontrollit të rregullt mbi të dhënat e përcjella nga RASH. Si rezultat, gjatë auditimit u evidentua se kopja e të dhënave e përcjellë me shkresën nr. 374, datë 16.10.2024, nuk përputhej me përcaktimet e marrëveshjes, duke reflektuar mungesën e kontrollit mbi përmbajtjen dhe vlefshmërinë e të dhënave të transferuara.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-26 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**8.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës të marrë masa për caktimin e personit përgjegjës, për monitorimin e realizimit të proceseve që janë objekt i marrëveshjes kuadër midis Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Rrjetit Akademik Shqiptar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Universiteti i Sporteve të Tiranës nuk disponon një përdorues si administrator sistemi dhe nuk ka një urdhër titullari për caktimin e një përdoruesi të tillë, në kundërshtim me Marrëveshjen Kuadër nr. 863 prot, datë 21.03.2024 “Për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”, pika 6, nën-pika 6.2, shkronja b.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-26 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**9.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës të marrë masa për caktimin e përdoruesit me të drejta administrative me qëllim garantimin e kontrolleve të brendshëm mbi aksesin dhe sigurinë e të dhënave të institucionit në sistem.

*Menjëherë*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi është konstatuar se Universiteti i Sporteve të Tiranës nuk disponon diagramë të rrjedhës së informacionit (workflow) nëpërmjet sistemit Pitagora, sikurse përcaktohet në praktikat më të mira të menaxhimit të proceseve të informacionit dhe ISSAI 5310 - Auditimi i Sigurisë së Sistemeve të Informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-26 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**10.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, të marrë masa për hartimin e diagrameve të qarkullimit të informacionit për secilin nga proceset që nis dhe përfundon nëpërmjet sistemit informatik, për gjurmimin e proceseve të automatizuara.

*Brenda vitit 2025*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se nuk janë ngritur grupe pune me qëllim: hartimin e rregullores për sistemin Pitagora, hartimin e rregullores për sistemin e monitorimit me video mbikëqyrje në Universitetin e Sporteve të Tiranës, përditësimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me marrëveshjen kuadër nr. 863 prot; datë 21.03.2024 “Për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit”. Mungesa e grupeve të punës për hartimin e rregulloreve të nevojshme kufizon kapacitetin e institucionit për të menaxhuar në mënyrë të rregullt dhe të sigurt sistemet informatike, monitorimin me video dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke rritur riskun e rrjedhjes së informacionit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-26 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**11.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve Tiranë të marrë masa për ngritjen e grupeve të punës me qëllim hartimin e rregullores për sistemin Pitagora, hartimin e rregullores për sistemin

e monitorimit me video mbikëqyrje në Universitetin e Sporteve të Tiranës dhe përditësimin e rregullores për mbrojtjen e të dhënave personale.

*Brenda vitit 2025*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i marrëveshjes kuadër nr. 863 prot; datë 21.03.2024 “Për ofrimin dhe përfitim të shërbimeve në fushën e teknologjisë së informacionit” dhe kërkesave që Universiteti i Sporteve të Tiranës ka përcjellë drejt Rrjetit Akademik Shqiptar, për shtimin e disa funksionaliteteve në sistemin Pitagora, u konstatua se nuk përcaktohet afat për realizimin e ndryshimeve. Gjithashtu, marrëveshja e shërbimit nuk parashikon penalitete në rastin e mos realizimit të tyre.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-26 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**12.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve Tiranë në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, të marrë masa për përcaktimin në marrëveshjen kuadër të afateve për realizimin e përmirësimeve në sistemin Pitagora që kërkohen nga UST dhe penalitete në rast të mos ofrimit të shërbimeve.

*Brenda vitit 2025*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se në sistemin Pitagora mungon një funksionalitet i dedikuar për gjenerimin automatik të notave dhe krediteve, për vërtetimin dhe suplementin e diplomës, të cilat lëshohen nga sekretariati në përfundim të ciklit të studimeve. Mungesa e funksionalitetit shton mundësinë për gabime njerëzore gjatë përpunimit manual të të dhënave dhe nuk përputhet me praktikën më të mira për menaxhimin e të dhënave.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-26 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**13.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve Tiranë në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, të marrin masa për ndërtimin dhe integrimin e një funksionaliteti në sistemin Pitagora, që mundëson gjenerimin automatik të notave dhe krediteve të studentëve. Kjo do të ndihmojë në reduktimin e punës manuale nga sekretariati dhe në shmangien e gabimeve njerëzore.

*Brenda vitit 2025*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi funksionalitetet e sistemit Pitagora është konstatuar se rubrika “Tipe evidencash” nuk jep informacion dhe nuk mund të gjenerohen raporte apo evidenca nga sistemi, në kundërshtim me Aneksin II të marrëveshjes kuadër me Rrjetin Akademik Shqiptar, pika “Disa nga rolet dhe detyrat”, nën-pika “Sekretaritë Mësimore”, shkronja g, ku cilësohet se duhet të jetë i mundur gjenerimi i këtyre statistikave për nevojat e punës së sekretariatit.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-26 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**14.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve Tiranë në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar të marrë masa për bërjen funksional të gjenerimit të raporteve nga sistemi Pitagora sipas formateve të kërkuara nga sekretariati, për shmangien e proceseve manuale dhe lehtësimin e monitorimit të punës.

*Brenda vitit 2025*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i ndërfaqes së përdoruesit IT është konstatuar se shfaqen rubrika të tjera që i takojnë sekretariatit dhe janë të panevojshme ti shfaqen këtij roli, pasi nuk janë objekt i detyrave dhe përgjegjësisë së tij. Shfaqja e funksionaliteteve që nuk i takojnë punës së përdoruesit rrit rrezikun e aksesit të paautorizuar në të dhëna ose procese të ndjeshme, gjë që mund të shkaktojë manipulim të paqëllimshëm ose keqpërdorim të informacionit. Gjithashtu, bie në kundërshtim me parimin e “privilegjeve minimale” (përdoruesi duhet të ketë vetëm nivelin minimal të aksesit dhe privilegjeve që i nevojiten për të kryer detyrat e tij, duke kufizuar qasjen në funksionalitete ose të dhëna që nuk janë të domosdoshme për punën e tij), duke cenuar

sigurinë dhe integritetin e sistemit, sikurse përcaktohet në Udhëzimet e Standardit Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27002:2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-26 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**15.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, të marrë masa që përdoruesit në rolin IT, ti shfaqen vetëm rubrikat objekt i detyrave funksionale dhe përgjegjësi të tij.

*Menjëherë*

**16. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi fjalëkalimet është konstatuar se sistemi në momentin e parë të log-imit, pas dërgimit në email të fjalëkalimit të gjeneruar prej tij, nuk të detyron për ndryshimin e këtij fjalëkalimi dhe nuk ka skadencë për fjalëkalimet (password expiration) duke kompromentuar sigurinë e llogarisë së përdoruesit, sikurse përcaktohet në Udhëzimet e Standardit Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27002:2022.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqet 13-26 të Projekt Raportit të Auditimit)*

**16.1 Rekomandimi:** Universiteti i Sporteve të Tiranës, në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar, të shqyrtojë mundësinë e përdorimit të një kodi të përkohshëm në rastet e ndryshimit të fjalëkalimeve dhe të sigurohet që në sistem zbatohet ndryshimi periodik i fjalëkalimeve, në përputhje me politikat dhe standardet e sigurisë.

*Brenda vitit 2025*

---

*Për sa më sipër, paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.*

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**